

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Strategjia për Kulturë e Prizrenit, një domosdoshmëri zhvillimore

30 shtator 2012, Prizren

Dje në Prizren u diskutua mbi nevojën e një Strategjie për Kulturën. Debat i bashkorganizuar nga Leo's Art Organization, Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren dhe Forumi Kulturor (Rrjeti i Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë), u mbajt në Hamamin e Gazi Mehmed Pashës në Prizren, ndërsa i parapriu ceremonisë së hapjes solemne të Festivalit të Skulpturës SculpEdu.

Në debat u konstatua se shembuj konkretë të zhvillimit të turizmit përmes aktiviteteve kulturore tashmë ekzistojnë në Prizren dhe se ky potencial ka nevojë të zhvillohet më tutje përmes një dialogu të strukturuar mes shoqërisë civile, qeverisë lokale dhe sektorit të biznesit. Panelistët dhe pjesëmarrësit e tjerë të debatit u dakorduan se zhvillimi lokal ekonomik i Prizrenit përmes kulturës dhe turizmit kulturor kërkon politika konkrete lokale, ndërsa Strategjia për Kulturë e Prizrenit, u vlerësua si dokument i duhur strategjik zhvillimor për qytetin.

Panelistë të debatit ishin Samir Hoxha, Drejtor i Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në komunën e Prizrenit, Florent Mehmeti nga Teatri ODA dhe Eroll Bilibani nga Dokufest. Përfaqësuesi i komunës së Prizrenit përsëriti përkushtimin institucional për bashkëpunim me sektorin e kulturës së pavarur, ndërsa dha zotimin për koordinim të sektorëve të ndryshëm të qeverisë lokale në procesin e hartimit të strategjive. Në anën tjetër, Eroll Bilibani nga Dokufest theksoi se mënyra e shpërndarjes së fondeve për kulturën është ndër arsyt kryesore pse duhet të kemi një Strategji për Kulturën. Për më tepër, ai nënvizoi nevojën për bashkëpunim sistematik mes qeverisë lokale dhe sektorit të kulturës së pavarur. Nga perspektiva qendrore, Florent Mehmeti reflektoi mbi përpjekjet e Forumit Kulturor për të nisur hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës, duke potencuar që hartimi i dokumenteve strategjike për kulturën mund të shkojë në mënyrë paralele në nivelin qendror dhe atë lokal. Ai gjithashtu e ndau përvojën e Teatrit ODA rreth hartimit të strategjive lokale të kulturës në bashkëpunim me tri komuna në Kosovë dhe tri në Maqedoni.

Disa nga rekomandimet e debatit ishin: koordinim institucional brenda komunës së Prizrenit mes strategjive të ndryshme sektorale, konkretizimi i bashkëpunimit mes qeverisë lokale dhe kulturës së pavarur, përfshirja e aktorëve të tjerë relevantë në procesin e hartimit të strategjisë për kulturën, ndërrimi i mentalitetit institucional ndaj kulturës dhe trajtimit të saj në raport me sektorët e tjerë të politikave publike dhe nisja e procesit të hartimit të strategjisë së kulturës për Prizrenin.

Debat i djeshëm ishte i dytë i serisë së debateve të nisura nga Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren, si pjesë e përpjekjeve të RrOK-ut për të avokuar për politika adekuate kulturore në nivel lokal dhe pasurim të ofertës kulturore dhe turistike të Prizrenit. Njëherit, ky debat u mbajt disa ditë pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit mes RrOK-ut dhe Drejtorisë komunale të turizmit dhe

zhvillimit ekonomik për të formalizuar bashkëpunimin qeveri lokale – shoqëri civile për zhvillimin ekonomik të qytetit bazuar në turizmin kulturor. U paralajmërua që krahas procesit të avokimit ndaj qeverisë lokale për politika kulturore, RrOK rregullisht do të organizojë debate për të përfshirë sa më shumë grupe të shoqërisë në këtë proces.

Rrjeti i Organizatave Kulturore i Prizrenit është rrjet joformal i organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Anëtarët e Rrjetit janë: EC Ma Ndryshe, Dokufest, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, GreenArt, X40, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri, Leo's Art Organization dhe Xhennet Comics

Ju falemnderit për pjesëmarrjen tuaj.

Me respekt,

Në emër të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren

Hajrulla Çeku, EC Ma Ndryshe (Sekretariati i RrOK-ut)

hajrulla.ceku@ecmandryshe.org & 049-116-448